

Kapitulli 2 – Mjeti 1: Matrica e lidershipit gjinor

Matrica e lidershipit gjinor është një nga mjetet themelore të diagnostikimit që përpqet të shkojë përtej statistikave të thjeshta duke kategorizuar stafin sipas gjinisë, si dhe sipas shkallës në të cilën ata dominojnë funksionet thelbësore të organizatës.

Sipas Phpunsal, “matrica përdor korniza të vendosura gjinore së bashku me fusha relevante tematike që zgjidhen nga studiuesi ose zbatuesi. Fushat e analizës gjinore përfshijnë: aksesin në burime, rolet dhe praktikën, normat dhe besimet, fuqinë vendimmarrëse dhe autonominë, si dhe ligjet, politikat dhe institucionet. Eksplorimi i mënyrave në të cilat pabarazitë shfaqen në të gjitha këto fusha siguron që një lente gjinore të aplikohet në mënyrë sistematike dhe që një fushë të mos privilegjohe mbi tjetrën.”

Tabela 1: Lista e kontrollit për hartëzimin e lidershipit

Niveli i ndikimit	Burra (Sasia)	Gra (Sasia)	Jo-binar/Të tjerë	Fushat kryesore të vendimmarrjes
Menaxhmenti i lartë (Bordi / Drejtorët)				Buxhetimi, Strategjia, Punësimi
Menaxhmenti i mesëm (Drejtues të departamenteve)				Dizajni i projektit, Udhëheqja e ekipit
Stafi operacional (Zyrtarë / Këshilltarë)				Zbatimi, Puna në terren
Stafi mbështetës (Administratë / Logjistikë)				Operacione të përditshme

Udhëzime për përdorim: Organizatat duhet ta plotësojnë këtë tabelë për të vizualizuar “segregimin horizontal” (p.sh., i gjithë stafi IT është mashkull) dhe “segregimin vertikal” (p.sh., 80% e stafit janë gra, por 100% e menaxhmentit të lartë janë burra).

Roli i gjinisë shtrihet përtej strukturës së brendshme të departamentit të burimeve njerëzore dhe përfshin edhe programet. Koncepti i dizajnit “neutral ndaj gjinisë” është një koncept i mangët që nuk merr parasysh mënyrën se si persona të gjinive të ndryshme e perceptojnë botën digjitale dhe fizike. Kur bëhet fjalë për dizajnin e vetë programit, organizata duhet të shqyrtojë nëse çështja e dhunës me bazë gjinore në internet (OGBV) është marrë në konsideratë që në fazën fillestare të programit.